



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. _____ Prot

Datë ____ . ____ 2014

RREGULLORE

“Mbi ndalimin e konsumit të duhanit në mjediset e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 9636, date 06.1.2006 “Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit”, ndryshuar me Ligjin Nr. 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9636, datë 06.11.2006”, në kuadrin e parandalimit të pasojave të dëmshme që sjell duhani në shëndetin e njeriut, sidomos konsumuesit pasiv si dhe mbrojtjen e ambienteve të punës brenda AKPT-së miratohet kjo rregullore e cila,

VENDOS:

Neni 1

Ndalohet konsumi i duhanit në të gjitha ambientet e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si :

- a) Zyrat;
- b) Korridoret;
- c) Tualetet;
- d) Automjetet;
- e) Mjediset e përbashkëta të qarkullimit brenda godinës.

Dhe vende të tjera brenda këtij institucioni, duke vendosur shenja paralajmëruese të madhësisë 40 cm² me mbishkrimin “NDALOHET DUHANI” në vende ku mund të lexohen nga largësia 5m.

(shënim: shifrat për shenjat e madhësisë duhet të merren nga KNMSHPD - Komisioni Ndersektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit).

Neni 2

Në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit do të publikohet në vend të dukshëm, një mesazh informues për ndikimin e duhanpirjes që ka ai në shëndet dhe rreziqet nga

produktet e duhanit. Për përmbushjen e këtij detyrimi ngarkohet Sektori i IT dhe Mirëmbajtjes së Regjistrit.

Neni 3

Për punonjësit të cilët e konsumojnë duhanin, caktohet hapësira jashtë objektit e cila do të përdoret ekskluzivisht si vendi ku do të konsumohet duhani në Institucion.

Neni 4

Për të gjithë punonjësit, të cilët do të identifikohen duke konsumuar duhan në vendet e përcaktuara sipas nenit 1, do të ndërmerren masa në zbatim të nenit 16/ë të Ligjit Nr. 9636, date 06.1.2006 “Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit”, i ndryshuar, ku janë të përcaktuara sanksionet me gjobë dhe do të ndërmerren masa disiplinore për personat që janë në shkelje të kësaj rregullore.

Neni 5

Me qëllim zbatimin rigoroz të ligjit antiduhan dhe kësaj rregullore, detyrohen të gjithë punonjësit që identifikojnë persona të cilët konsumojnë duhanin brenda institucionit të AKPT-së, të lajmërojnë personin përgjegjës në mënyrë që të merren masat e nevojshme.

Neni 6

Personi përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore është **Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**. Personi përgjegjës është i detyruar në vendosjen e shenjave të dukshme, të cilat demonstron se pirja e duhanit në këto mjedise ndalohet si dhe të mundësojë heqjen dhe moslejimin e taketukeve të cigareve.

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

ADELINA GRECA

DREJTORI I PERGJITHSHEM

AGJENCIA KOMBETARE E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT